

Data 27.07.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje 3000 kazanë mbeturinash”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 44613700-7

VLERA E FONDIT LIMIT: 153.000.000 (Njëqind e pesëdhjetë e tre milione) Lekë pa TVSH, ekuivalente në 1,632,522 (Një milionë e gjashtëqind e tridhjetë e dy mijë pesëqind e njëzet e dy) Euro me kurs kembimi 93.72 (referuar Bankes së Shqipërisë date 24.07.2026).

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Eco Tirana sh.a. ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Kërkesat e mësipërme janë detyruese dhe i shërbejnë Autoritetit Kontraktor për të krijuar bindjen e tij se operatorët ekonomik pjesëmarrës ushtrojnë veprimtarinë e tyre konform kërkesave të legjislationit në fuqi, përmbushin kriteret ligjore për të marrë pjesë në procedura prokurimi si dhe kanë shlyer të gjitha detyrimet sipas përcaktimeve të legjislationit përkatës.

Po ashtu, paraqitja e sigurimit të ofertes është detyrim ligjor i përcaktuar nga legjislationi në fuqi, si një mjet garancie për Autoritetin Kontraktor në rast të tërheqjes së ofertës pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave; refuzimit për nënshkrimin e kontratës së prokurimit apo mosparaqitjes së sigurimit të kontratës, kur oferta është shpallur fituese, ose mosplotësimit të ndonjë kushti tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentet e tenderit.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1.1 Ky kriter plotësohet nëpërmjet dorëzimit të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës së Formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të LPP, pika 1 a dhe 2 si dhe nenit 22 të ligjit nr. 16 dt.08.02.2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik".

*(Shënim: përcaktoni **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit).*

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023- 2024-2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera limit e kontratës që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP, si dhe nenin 43, pika 1 dhe pika 2 germa a) dhe pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e vlerës është përcaktuar bazuar në nenin 43, pika 2 germa b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.26/2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike".

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore të çertifikuara të paraqitura pranë autoriteteve tatimore përkatëse, për vitet financiare 2023-2024-2025 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të Ligjit për Kontabilitetin dhe raportimin financiar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

(Shënim: ky kriter vendoset vetëm në rastet kur vlerësohet nga autoriteti/enti kontraktor)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht në Ligjin nr.29/ 2023, datë 2.05.2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe VKM Nr. 922, datë 29.12.2014 *PËR DORËZIMIN E DEKLARATAVE TATIMORE DHE TË DOKUMENTEVE TË TJERA TATIMORE, VETËM NËPËRMJET FORMËS ELEKTRONIKE (Ndryshuar me VKM nr. 211, datë 9.4.2025).*

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 39 % të vlerës së fondit të limitit të kësaj kontrate

(apo shumatores së fondit limit të loteve, nëse kontrata është e ndarë në lote dhe ofertohet për më shumë se një lot).

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Referuar VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” nenit 40, pika 4 ku është përcaktuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39 % të vlerës së fondit limit, për të vërtetuar aftësitë teknike të OE me qëllim përmbushjen nevojave të AK.

2.4.Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

- 2.4.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar për produktet e ofruara ku të përcaktohen edhe kontaktet e prodhuesit ose distributorit të autorizuar. Në rast se një autorizim paraqitet nga distributori i autorizuar, lidhja, bashkëpunimi i kontratës / furnizimit, ndërmjet distributorit të autorizuar dhe prodhuesit duhet të jetë e paraqitur me dokumentacionin përkatës.
- 2.4.2. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatën ISO 9001: 2015 në lidhje me sistemin e menaxhimit të cilësisë ose ekuivalente. Certifikata duhet të jetë e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga RSH”.
- 2.4.3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një Certifikatë Konformiteti të ngjashme me mallrat e shitura, UNI EN 840-4:2013, UNI EN 840-5:2013, UNI EN 840-6:2013, ose ekuivalente. Për standardet e mësipërme, AK pranon edhe mundësinë e paraqitjes së standardit SSH/EN; SSH/ISO etj, mbi konformitetin e standardit europian apo atij ISO, dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.
- 2.4.4. Operatori ekonomik duhet të deklarojë se do të dorëzojë kazanet prane ambjenteve të Selisë Operative të Eco Tirana Sh.a. ish parku i autobusave Rruga Don Bosko Tiranë sipas grafikut të lëvrimit të mallit.
- 2.4.5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një Certifikatë EN ISO 1461:2009 Veshjet me galvanizim në të nxehtë të artikujve të prodhuara prej hekuri dhe çeliku – Specifikime dhe metodat e provave, ose ekuivalente.
- 2.4.6. Ditën dhe orën e hapjes së Ofertave subjekti Ofertues duhet të paraqesë një mostër kazan, me etiketë të dallueshme ku të vendosen të dhënat si më poshtë:
mostër “emri për secilin artikull” datën e zhvillimit të tenderit, emrin e prodhuesit/ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik, të cilat do mbahen nga Autoriteti Kontraktor sipas rregullores.

Argumentim: Në bazë të nenit 77 pika 4 të Ligjit Nr 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikës 6, gërma a dhe pikës 8 të nenit të 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ndryshuar dhe pikës 1 të nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ndryshuar.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Hartimi i specifikimeve teknike është kryer nga Eco Tirana sh.a. duke iu referuar kërkesave dhe nevojave të autoritetit kontraktor Eco Tirana sh.a. në fushën e veprimtarisë së tij, referuar blerjeve të mëparshme dhe unifikimit të zonës ku ushtron aktivitetin në bazë të kontratës së shërbimit të administrimit të mbetjeve urbane dhe zgjerimit të shërbimit.

ARTIKULLI	PERSHKRIMET/SPERCIFIKIMET TEKNIKE	NJESI MATESE	SASIA
Kazane metalikë me kapak për grumbullimin e mbeturinave 1700 LT	Kazanë metalikë me kapak për mbledhje mbeturinash me kapacitet 1700 litra Materiali Vaska, e ndërtuar me fletë çeliku me cilësi minimale DC04 (me stampim të thellë) me trashësi minimale 1.5 mm, stampuar me brinjë horizontale ngurtësimi përgjatë faqeve të kazanit, zinkuar në të nxehtë, duhet të garantojë mbyllje hermetike të përsosur, ndërsa pjesa e sipërme e vaskës duhet të forcohet më tej nga një “brez” i realizuar me tub çeliku me trashësi minimale 2.5 mm, salduar në brinjën e sipërme, për të mos krijuar relieve në pjesën e poshtme të vaskës dhe, përveç kësaj, këndet e pasme të brendshme duhet patjetër të përforcohen. Vaska, PASI TË JETË SALDUAR, do t’i nënshtrohet një trajtimi zinkimi në të nxehtë, realizuar konform	Cope	3000

	normativës UNI-EN-ISO-1461, me dendësi minimale zinku 60 mikron dhe më pas të lyhet me pluhura poliesteri. Saldimi i vaskës duhet të ekzekutohet me makineri të automatizuara që sigurojnë cilësi të përsosur në mënyrë konsistente. Saldimet e pjesëve të çelikut duhen bërë në mënyrë të tillë që të mos lënë skorje. Kontejneri duhet të ketë një kapacitet prej 1700 litrash. Përmasat Përmasat duhet të jenë të përshtatshme për të gjitha makineritë e ngritje-shkarkimit në pronësi të këtij enti, pa krijuar pengesa të çfarëdo lloji në të gjitha fazat e ciklit të lëvizjes së tyre. Kapakët Kapakët duhet të jenë prej politileni PEHD, me teknologji stampimi rrotullues me dy faqe, me hapje si të librit. Kapaku duhet të zere 2/3 për të lehtësuar zbrazjen e mbeturinave. Menteshat Menteshat duhet të realizohen nëpërmjet një gjilpëre çeliku inox në të gjithë gjatësinë rreth brendësisë së kapakut dhe duhet të lejojnë një shpërndarje të tërheqjeve dhe shtypjeve. Rrotat Katër rrotat duhet të kenë një diametër 200x50 me rreth çeliku të zinkuar, unazë gome të plotë superelastike, mbështetje rrotulluese mbi sfera, unazë për mbrojtjen ndaj pluhurave, mekanizëm bllokimi me frenë me pedal te rrotat e pasme dhe unazë me kanal rrëshqitjeje prej çeliku inox. Pjesët metalike Të gjitha pjesët metalike duhet të mbrohen mirë nga oksidimi dhe agjentët atmosferikë. Për sa i përket procesit të zinkimit në të nxehtë me zhytje, duhet të zbatohen rregullat konform normativës UNI-EN-ISO-1461:2009 (veshjet e përfutuara me zinkim të nxehtë mbi produkte hekuri). Lyerja 1. Paratrajtimi (fosfosgrasatimi/fosfodeoksidimi): Vaskat e çelikut pësojnë një trajtim sgrasatimi dhe një konvertim kimik sipërfaqësor me bazë fosfatesh, me tretësira ujore me bazë acidi ortofosforik dhe tensioaktive, të hedhura në temperaturën 50°C. 2. Shpëlarja: produkteve u duhet bërë një larje e dyfishtë për të zhdukur mbetje nga ndonjë trajtim i mëparshëm, në fillim me ujë rubineti e më pas me ujë të demineralizuar. 3. Tharja: produktet duhet të pushojnë në një furrë tharjeje me ajër të nxehtë në temperaturën 140-150° C,	
--	---	--

	në mënyrë që para se të të kalojnë në fazën e depozitimit të pluhurave të jenë komplet të thata. 4. Aplikimi i pluhurave: Aplikimi i bojës në formë pluhuri nëpërmjet elektrodepozitimit. Të gjitha pluhurat e përdorura duhet të jenë pa metale të rënda, ose "TGCI free". 5. Polimerizimi (pjekja): Pjekje në furrë me ajër të nxehtë me temperaturë të ndryshueshme 180-220° C për kohën që i duhet pluhurave të polimerizohen. Aksesore etj. Kazanët duhet të jenë të pajisur me nga dy doreza për çdo anë, të vendosura në pjesën e përparme, ku do të kapen nga punonjësit. Format e dorezave dhe pozicionimi i tyre duhet të rezultojnë të tilla që të mos dëmtojnë punonjësin (konform normativave UNI). Në cepat vertikalë të kontejnerit duhet të aplikohet sinjalistika e përshkruar në kodin rrugor për pengesat fikse në zonat me qarkullim pak të ndriçuara (me vija të kuqe e të bardha dhe gradë kaporali). Duhet përdorur një material reflektues i llojit SCOTCHLITE-ENGINEER GRANDE HIGH TACK 16050 ose i ngjashëm Në fund duhet vendosur një tapë e vetme shkarkimi me diametër minimal 40mm. Pesha e përgjithshme max 142 kg i kompletuar me kapak Ngjyra: 3000 kazane me ngjyre blu RAL 5015 3000 kapake me ngjyre gri RAL 7016 Kazanet duhet të dorezohen prane zyres operative të Eco Tirana Sh.a ish parku i autobusave Don Bosko		
--	--	--	--

Përcaktimi i specifikimeve teknike për furnizimin me kazanë metalikë me kapak me kapacitet 1700 litra është bërë në përputhje me nevojat operative të Eco Tirana sh.a. për garantimin e një shërbimi efikas, të sigurt dhe të qëndrueshëm të grumbullimit të mbetjeve urbane. Kërkesat teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë kushtet intensive të përdorimit në ambiente të jashtme, përputhshmërinë me sistemet ekzistuese të ngritje-shkarkimit, si dhe standardet evropiane për kontejnerët e mbetjeve. Specifikimet lidhur me materialin, konstruksionin metalik, procesin e zinkimit në të nxehtë, mbrojtjen kundër korrozionit, cilësinë e saldimeve, kapakun prej PEHD, sistemin e rrotave, elementët e sigurisë dhe përfundimin me lyerje elektrostатike janë përcaktuar me qëllim sigurimin e një produkti rezistent, funksional dhe me jetëgjatësi të lartë, i cili përballon ngarkesat mekanike, kushtet atmosferike dhe përdorimin e vazhdueshëm në shërbimin publik të pastrimit. Gjithashtu, kërkesat për dimensionet, peshën, ngjyrat dhe elementët reflektues janë vendosur për të garantuar përdorim të sigurt nga punonjësit, integrim me flotën ekzistuese të mjeteve dhe identifikim të lehtë në terren. Të gjitha kërkesat teknike janë përcaktuar në përputhje

me standardet **UNI EN 840-4:2013, UNI EN 840-5:2013, UNI EN 840-6:2013 dhe UNI EN ISO 1461:2009**, ose ekuivalentet e tyre, duke garantuar cilësi, siguri dhe përshtatshmëri të plotë për qëllimin e përdorimit.